



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

# DËSHTIMI I SHTETIT NDAJ “KOBRES”

PRISHTINË, JANAR 2023

Autorë: Medina Kadriu dhe Albijona Hoxhaj

Redaktor: Gzim Shala

Me kontribut të veçantë: Lavdim Makshana

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit dhe RBF-së.*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

## IKD

Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:

Janar, 2023  
Prishtinë, Republika e Kosovës



## Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive .....	4
2. Recidivizmi i “Kobrës” .....	5
3. Vrasja e 3 janarit 2023 në lokalin “Kobra City” .....	7
4. Dështimi i politikës ndëshkimore ndaj një recidivisti .....	8
4.1. Qasja në armë .....	9
4.2. Lokali “Kobra City” .....	9
5. Heshtja e KPK-së dhe KGJK-së .....	10

## 1. Përmbledhja ekzekutive

Më 3 janar 2023, dyshohet se pas konfliktit lidhur me pagesën e faturës së shërbimeve në lokalit “Kobra City”, një 31 vjeçar gjeti vdekjen, e derisa një tjetër u plagos. Deri te vdekja e 31 vjeçarit dyshohet se erdhi nga arma që u shkrep nga një recidivist i veprave penale, për të cilin, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), përmes platformës “Betimi për Drejtësi”, kishte raportuar se ka 16 aktgjykime dënuese të formës së prerë. Ky recidivist në media proklamohet se ka kryer 198 vepra penale, derisa bënte të ditur se e gjithë kjo e kaluar e tij kriminale filloi me rastin e hapjes së lokalit të lartcekur.

Në 16 aktgjykimet e analizuara nga IKD, rezulton se i njëjti ishte dënuar vetëm me dënime me kusht e me gjobë. Ndër veprat penale për të cilat Dibran Hoxhaj i njohur si “Kobra” është dënuar më shumë se dy herë është vepra penale e armëmbajtjes pa leje. Por, këto dënime nuk do ta ndalonin të njëjtin që të posedonte sërish armë, dhe të kryente vepër penale më të rëndë, si ajo e privimit nga jeta të një personi, ashtu siç po dyshon Prokuroria Themelore në Prizren. Në të gjitha këto raste, është paraparë mundësia e aplikimit të dënimeve më të ashpra ndaj tij, por se në asnjë prej tyre, i njëjti nuk është dënuar me burgim efektiv, as pasi i njëjti kishte përsëritur këto vepra penale recidivizmi i tij ishte konstatuar.

Rasti “Kobra” është rast i pakontestueshëm në të cilin sistemi i drejtësisë ka dështuar të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, e njëherit ka dështuar të mbrojë shoqërinë nga një kryes i veprave penale, përmes politikave ndëshkimore joadekuate, respektivisht përmes dënimeve me gjobë e me kusht të një pas njëshme, me ç’rast si rezultat i mosveprimeve adekuate në rehabilitimin e një kryesi recidivist të veprave penale nga ana e sistemit të drejtësisë, një person është privuar nga jeta. Fatkeqësisht, ky rast vie vetëm disa ditë pasi IKD përmes një analize gjeti se në duar të shtetit u vra edhe një viktimë e dhunës në familje, Saime Domazeti.

Në shtetet demokratike, ku sundon ligji, në mënyrë të pavarur dhe paanshme, ku integriteti i sistemit të drejtësisë mbrohet skajshëm, në rrethanat e rastit “Kobra”, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), do të duhej të alarmoheshin nga dështimi i sistemit të drejtësisë, në parandalimin e një recidivisti nga kryerja e veprave penale dhe mbrojtja e të drejtës themelore, të garantuar në çdo shoqëri demokratike, që është jeta e një personi. Fatkeqësisht, deri më tani, as në këtë rast nuk kanë reaguar këto institucione, ngjashëm siç nuk kishte reagim institucional adekuat as në rastin e vrasjes së Saime Domazetit.

Situata të tilla, do të duhej të ishin alarmante, në drejtim të mbajtjes përgjegjës të gjithë personave zyrtar, të cilët me mosveprimin apo veprimin e tyre, nuk i përmbushin obligimet dhe përgjegjësitë e tyre që burojnë nga ligji dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe atribuojnë në një klimë, ku persona me të kaluar voluminoze kriminale gjenden në liri dhe me lehtësi promovojnë krimin dhe kryejnë vepra penale. Të gjitha këto në sy të institucioneve që përgjegjësi kanë parandalimin, hetimin dhe dënimin e kryesve të veprave penale. Por, institucionet kanë zgjedhur të heshtin dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim në gjetjen e përgjegjësve në këtë hallkë dështimi të institucioneve.

## 2. Recidivizmi i “Kobrës”

Dibran Hoxha, i njohur si “Kobra”, nuk u bë i njohur për publikun e as për sistemin e drejtësisë, për herë të parë më 3 janar 2023, me rastin e fitimit të statusit si i dyshuar kryesor për kryerje të vrasjes së një 31-vjeçar nga Kukësi, ku i plagosur mbeti dhe një person tjetër.

“Kobra” për sistemin e drejtësisë njihej pasi i njëjti ishte i dënuar me gjithsej 16 aktgjykime të formës së prerë. Për publikun njihej si figurë, i cili në emisione të ndryshme televizive, prezantohej me të kaluarën e tij kriminale, duke thënë se ka kryer 198 vepra penale, por që gjitha sipas tij kishin lindur pasi kishte hapur lokalitë e tij “Kobra City”. Ndër të tjera, bënte të ditur se armë ka mbajtur nisur nga fakti se ka hasmëri me familje të ndryshme.<sup>1</sup>

Instituti i Kosovës për Drejtësi, përmes platformës së saj, “Betimi për Drejtësi”, në shkurt të vitit 2022 kishte gjetur se Hoxhaj është dënuar 16 herë, ndërsa kishte ende edhe një lëndë aktive në gjykatë.<sup>2</sup> Sipas Prokurorisë Themelore në Prizren, ndaj të njëjtit ishin ngritur mbi 30 kallëzime penale, ku disa kishin përfunduar më aktakuza e disa ishin hedhur poshtë.<sup>3</sup>

Lëndime të rënda e të lehta trupore, armëmbajtje pa leje, kanosje, dëmtim të pasurisë së huaj, janë disa nga veprat penale, për të cilat “Kobra”, është dënuar. Aktgjykimet në fjalë janë shpallur gjatë periudhës kohore 2007 – 2021.<sup>4</sup>

Nga 16 aktgjykimet e siguruar nga “Betimi për Drejtësi”, z.Hoxhaj është dënuar me gjobë në 12 aktgjykimet e plotfuqishme, kurse në katër (4) aktgjykimet tjera është dënuar me dënim me kusht.

Të dhënat për secilin dënim të shqiptuar ndaj z.Hoxhaj janë paraqitur në tabelën më poshtë<sup>5</sup>:

---

<sup>1</sup> “Kobra” praktikues i fesë islame me 198 vepra penale”. Sui Generis. 18 qershor 2021. (Shih linkun: [https://video.gjirafa.com/kobra-pratikues-i-fese-islame-me-198-vepra-penale?fbclid=IwAR2DtQADHmPfnAvb\\_3LcpFu0PAI3FzMoDsVUM2lendbdzBiSmV3zCxVbSJw](https://video.gjirafa.com/kobra-pratikues-i-fese-islame-me-198-vepra-penale?fbclid=IwAR2DtQADHmPfnAvb_3LcpFu0PAI3FzMoDsVUM2lendbdzBiSmV3zCxVbSJw) ). (Qasur për herë të fundit më 4 janar 2023).

<sup>2</sup> “Kobra”, i dënuar 16 herë për vepra të ndryshme penale”. Betimi për Drejtësi. 6 shkurt 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kobra-i-denuar-16-here-per-vepra-te-ndryshme-penale/?fbclid=IwAR1M4M7KGIGkvV1xOclLAZsA8oaIVPxeCgNh95H6m6ZdKZsQz9vGuprLOnk> ). (Qasur për herë të fundit më 4 janar 2023).

<sup>3</sup> Përgjigje e Prokurorisë Themelore në Prizren me 28 dhjetor 2022.

<sup>4</sup> “Kobra”, i dënuar 16 herë për vepra të ndryshme penale”. Betimi për Drejtësi. 6 shkurt 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kobra-i-denuar-16-here-per-vepra-te-ndryshme-penale/?fbclid=IwAR1M4M7KGIGkvV1xOclLAZsA8oaIVPxeCgNh95H6m6ZdKZsQz9vGuprLOnk> ). (Qasur për herë të fundit më 4 janar 2023).

<sup>5</sup> Po aty.

Vendimi i formës së prerë	Vepra penale	Dënueshmëria sipas ligjit	Dënimi i shqiptuar
26.06.2009	Neni 328 par. 1 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	Gjobë deri në 10 mijë euro ose Burgim 1-10 vite	Dënim me Gjobë 1.000 euro
16.11.2007	Neni 155 par. 1 Pjesmarrja në rrahje	Gjobë ose Burgim deri në 1 vit	Dënim me kusht – 6 muaj burgim në kohëzgjatje verifikimi prej 1 viti
23.10.2012	Neni 328 par. 2 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	Gjobë deri 7 mijë e 500 euro ose Burgimi 1-8 vite	Dënim me Gjobë 800 euro
23.10.2012	Neni 328 par. 2 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	Gjobë deri 7 mijë e 500 euro ose Burgimi 1-8 vite	Dënim me Gjobë 850 euro
07.10.2014	Neni 260 par. 1 Dëmtimi i pasurisë së huaj të luajtshme	Gjobë ose Burgim deri në 6 muaj	Dënim me Gjobë – 300 euro Dënim me Kusht – 6 muaj burgim në kohëzgjatje verifikimi prej 2 vitesh
23.03.2015	Neni 153 par. 1 Lëndim i lehtë trupor	Gjobë ose Burgim deri në 1 vit	Dënim me Kusht – 3 muaj burgim në kohëzgjatje verifikimi prej 1 viti
15.05.2013	Neni 153 par. 1 dhe 2 Lëndim i lehtë trupor	Burgim deri në 3 vite	Dënim me Gjobë - 250 euro
15.05.2022	Neni 154 par. 1 Lëndim i rëndë trupor	Burgim 6 muaj deri në 5 vite	Dënim me Gjobë 200 euro
13.08.2018	Neni 185 par. 1 Kanosje	Gjobë ose Burgim deri në 6 muaj	Dënim me Gjobë 140 euro
13.08.2018	Neni 188 par. 1 Lëndim i lehtë trupor	Gjobë ose Burgim deri në 1 vit	Dënim me Gjobë 200 euro
10.12.2018	Neni 188 par. 1 Lëndim i lehtë trupor	Gjobë ose Burgim deri në 1 vit	Dënim me Gjobë 300 euro Dënim me Kusht 6 muaj burgim në kohëzgjatje verifikimi prej 1 viti
25.03.2019	Neni 313 par. 2 Shmangie nga tatimi	Dënohet me gjobë dhe Burgim prej 6 muaj deri në 5 vite	Dënim me Gjobë 1.500 euro
04.05.2020	Neni 185 par. 1 dhe nën par. 1.4 Lëndim i lehtë trupor	Gjobë ose Burgim deri në 3 vite	Dënim me Gjobë 1.000 euro
19.02.2021	Neni 186 par. 1 lidhur me par. 1.2 dhe par. 3 në lidhje me nenin 31 Lëndim i rëndë trupor	Deri në 10 vite burgim	Dënim me Gjobë 2.340 euro
01.11.2021	Neni 406 Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare	Gjobë ose Burgim deri në 3 vite	Dënim me Gjobë 160 euro
03.05.2016	Neni 188 par. 1 Lëndim i lehtë trupor	Gjobë ose Burgim deri në 1 vit	Dënim me Gjobë 1.600 euro

**Tabela 1: Dënimet e shqiptuara ndaj Dibran Hoxhës.**

### 3. Vrasja e 3 janarit 2023 në lokalit “Kobra City”

Edhe pas 16 dënimeve të shqiptuara, “Kobra” po përballet sërish me drejtësinë. Rasti ka të bëjë me vrasjen e një 31 vjeçari nga Kukësi, në të cilin rast i plagosur ka mbetur edhe një person tjetër. Sipas Prokurorisë Themelore të Prizrenit, vrasja dyshohet se ka ndodhur pas konfliktit lidhur me pagesën e faturës së shërbimeve në lokalit “Kobra City”. Për këtë rast, Dibran Hoxha po dyshohet për veprat penale vrasje të rëndë, armëmbajtje pa leje dhe manipulimi me prova, ndërsa Arben Vezaj, Burim Mazreku, Jesmir Badalli, Kujtim Gashi dhe Enver Amrllahi, po dyshohen për veprën penale “Pjesëmarrja në rrahje”.<sup>6</sup>

Sipas Prokurorisë Themelore në Prizren, “Kobra”, më datën 03 janar 2023, rreth orës 04:00, në afërsi të lokalit të tij “Kobra City”, që gjendet në rrugën magjistrale Prizren- Zhur, me armë zjarri, me dashje e privon nga jeta viktimën V.C, duke vë në rrezik jetën e të dëmtuarit R.Sh, të cilin e plagos dhe duke vë në rrezik edhe jetën e të dëmtuarit A.B, që të tre shtetas të Republikës së Shqipërisë, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje paraprake që kishin pasur rreth pagimit të faturës në lokal, fillon përlëshja në mes punëtorëve në lokalit “Kobra City”, me të dëmtuarit ku pas kacafytjeve dhe rrëmujës së krijuar në lokal, të dëmtuarit dalin nga lokali dhe pasi hypin në veturën “Mercedes” FA 19-PFX, me targa angleze, për tu larguar në parkingun e lokalit, paraqitet i dyshuari Dibran Hoxha, i cili me armë zjarri shtie në drejtim të veturës, me ç’rast e qëllon të dëmtuarin V.C, i cili kishte qenë i ulur në ulësen e pasme të veturës dhe R.Sh, i cili kishte qenë i ulur në ulësen e përparme, dhe si pasojë e këtyre të shtënave me armë zjarri V.C ndërron jetë rrugës për në spitalin e Kukësit, derisa R.Sh për shkak të plagëve të marra transferohet nga Spitali i Kukësi në Spitalin e Tiranës. Me këtë, Hoxha dyshohet se ka kryer veprën penale “Vrasje e rëndë” nga neni 173, paragrafi 1, nënparagrafi, 1.5 të Kodit Penal.<sup>7</sup>

Mbi bazën e kërkesës për caktimin e paraburgimit së Prokurorisë Themelore në Prizren, Gjykata Themelore në Prizren i ka shqiptuar të dyshuarit Hoxha i njohur si “Kobra” dhe pesë të dyshuarve tjerë masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditëve. Pra gjashtë të dyshuarit do të jenë nën masën e paraburgimit prej 3 janarit deri më 3 shkurt 2023 sipas vendimit të gjykatësës paraprake, Teuta Krusha.<sup>8</sup>

---

<sup>6</sup> “Prokuroria kërkon paraburgim për “Kobrën” dhe pesë të tjerët”, Betimi për Drejtësi. 4 janar 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-paraburgim-per-kobren-dhe-pese-te-tjeret/>). (Qasur për herë të fundit më 4 janar 2023).

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> “Nga një muaj paraburgim ndaj “Kobrës” dhe pesë të tjerëve për vrasjen në Prizren”. Betimi për Drejtësi. 4 janar 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/nga-nje-muaj-paraburgim-ndaj-kobres-dhe-pese-te-tjereve-per-vrasjen-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 4 janar 2023).

#### 4. Dështimi i politikës ndëshkimore ndaj një recidivisti

Se ndaj tani të dyshuarit z.Hoxhaj ishte zbatuar politikë jo adekuate ndëshkimore nga gjykatat dëshmohet me vetë faktin e dënimeve minimale me gjobë dhe dënime me kusht në 16 rastet ku ishte dënuar i njëjti.

“Kobra” është dënuar me dënime me gjobë në 12 prej rasteve gjyqësore, derisa në katër (4) raste të tjera ndaj tij gjykatat kanë shqiptuar dënim me kusht. Për veprat penale për të cilat është dënuar z.Hoxha, dënueshmëria sipas ligjit ka shkuar deri në 10 vite burgim. (Shih tabelën nr.1). Por, në të gjitha këto raste, gjykatat ishin kufizuar në dënimin me gjobë dhe me kusht ndaj z.Hoxhaj duke shqiptuar dënime në minimumin e tyre dhe në asnjë rast nuk ishte shqiptuar dënim me burgim efektiv. Recidivizmi i z.Hoxhaj nuk kishte ndikuar në vendimet e gjykatës mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Neni 38 i Kodit Penal ka paraparë se qëllimet e dënimit janë: *1.1. të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; 1.2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; 1.3. të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe 1.4. të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.*

Në mënyrë që dënimi i shqiptuar të arrijë qëllimet e tij, Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka përcaktuar rregullat mbi përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Njëri prej parimeve të përgjithshme sipas të cilit gjykata duhet të udhëhiqet me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit është sjellja e mëparshme e të pandehurit<sup>9</sup>: *“Kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer veprë penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur”* thuhet në Kodin Penal [neni 69.5].

Neni 70 i cili flet për rrethanat e përgjithshme për zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, ka paraparë që me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh, ndër të tjera, ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar.

Sa i përket të recidivizmit si rrethanë rënduese Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Politikën Ndëshkimore nënvizon se *“[k]jo rrethanë njeh bindjen e përgjithshme se individët të cilët kanë kryer vepra penale në të kaluarën duhet të dënohet më ashpër sesa ata të cilët nuk kanë kryer. Ajo gjithashtu pranon se dënimet e mëparshme kanë dështuar në rehabilitimin apo reformimin e kryerësit. Në esencë, qëllimi i dënimit fillon të shmanget nga perspektiva e rehabilitimit në drejtim të konceptit të parandalimit të veprave të kryerësit në të ardhmen”*<sup>10</sup>.

<sup>9</sup> Neni 69.3.3.5, Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe [https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore\\_Shkurt%202018.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf) faqe 38 dhe 52.

<sup>10</sup> “Udhëzues për Politikën Ndëshkimore”. Prishtinë 2018. Faqe 97. (Shih linkun: <https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep->



Në anën tjetër, duke i cilësuar recidivistët si delikuent më problematikë, Kodi Penal [neni 75] ka paraparë edhe dispozita të veçanta për personat recidivistë.

Të gjitha këto dispozita ligjore duket se nuk kanë ndikuar në rastin e z. Hoxha. Kjo pasi përkundër faktit se i njëjti është dënuar plot 16 herë për vepra të njëjta dhe të ndryshme penale, kjo nuk ka ndikuar në asnjërin prej këtyre rasteve që gjykata të shqiptojë dënim me burgim efektiv, të paktën në minimumin e përcaktuar me ligj.

Kështu, dënimet e vazhdueshme me gjobë dhe kusht në asnjë rast nuk kanë arritur qëllimin e tyre derisa edhe pas dënimit të 16-të, z. Hoxha prapë dyshohet se është i përfshirë në një vepër penale të vrasjes së rëndë. Kështu, rasti “Kobra” është rast i pakontestueshëm në të cilin sistemi i drejtësisë ka dështuar të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, e që është njëri prej qëllimeve të dënimit. Për më tepër, në këtë rast, institucionet e sistemit të drejtësisë kanë dështuar të mbrojnë shoqërinë nga një kryes i veprave penale, përmes politikave ndëshkimore joadekuate, respektivisht përmes dënimeve me gjobë e me kusht të një pas njëshme, me ç’rast si rezultat i mosveprimeve në rehabilitimin e një kryesi recidivist të veprave penale nga ana e sistemit të drejtësisë, janë kryer vazhdimisht vepra penale nga z. Hoxha, derisa edhe pas 16 dënimeve dyshohet se nga veprimet e z. Hoxha një person është privuar nga jeta.

#### **4.1.Qasja në armë**

Siç shihet nga tabela 1, z. Hoxha është dënuar tri herë për veprën penale të mbajtjes së paautorizuar të armëve. I njëjti person, si recidivist i veprës penale të mbajtjes së paautorizuar të armëve, përmes një arme të paautorizuar, me 3 janar 2023, dyshohet se ka privuar një person nga jeta.

Kështu, recidivizmi i vazhdueshëm i z. Hoxha nuk kishte ndikuar që ndaj tij të merren masa më të ashpra dhe z. Hoxha të mos ketë qasje në armë. Me këtë rast, institucionet e drejtësisë, duhet të sqarojnë për publikun se si është e mundur që një recidivist i kësaj vepre penale, sërish përfundon me qasje në armë përmes së cilës dyshohet se është kryer një vepër e rëndë penale, si privimi i një personi nga jeta. Po ashtu, institucionet duhet të sqarojnë për publikun se si është e mundur që një person i dënuar në vazhdimësi për armëmbajtje pa leje sërish posedon armë dhe lëviz lirshëm derisa shkak i rënies në pranga bëhet dyshimi i institucioneve të drejtësisë për vrasjen e një personi.

#### **4.2.Lokali “Kobra City”**

Konflikti lidhur me pagesën e faturës së shërbimeve në lokalin “Kobra City”, sipas prokurorisë, u bë shkak për vrasjen në fjalë. Sipas vet të dyshuarit në këtë rast, pas hapjes së këtij lokali, i njëjti ishte përfshirë në gjithsej 198 vepra penale.

---

[content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore\\_Shkurt%202018.pdf](content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 5 janar 2023).

Është e pashmangshme ngritja e pyetjeve lidhur me veprimtarinë e lokalit në fjalë. Në këtë lokal, për të cilin personi në fjalë, në media deklarohet se është bërë shkak për të kryer 198 vepra penale, pronari i së cilës është një person me 16 aktgjykime dënuese të formës së prerë, a janë bërë hetime nga organet e drejtësisë lidhur me veprimtaritë e lokalit të lartcekur? A janë kryer bastisje, a është monitoruar nëse lokali operon me leje të lëshuar nga organi kompetent, a është monitoruar nëse lokali gjatë operimit të tij tejkalon veprimtaritë për të cilat ka leje, nëse ka pasur. A është monitoruar nëse ky lokal operon dhe kryen obligimet në përputhje me legjislacionin aktual, a janë kryer bastisje në lokalin, pronari i të cilit është recidivist i armëmbajtjes pa leje dhe veprave tjera penale dhe në fund përmes armës sërish kryen vepër më të rëndë penale se sa mbajtja e paautorizuar e armës.

Kjo heshtje e sistemit të drejtësisë përballë një personi që prezantohet në media si kryes i 198 veprave penale dhe i dënuar 16 herë për vepra të tilla, krijon një pasiguri të theksuar tek shoqëria, ku institucionet e sistemit të drejtësisë dështojnë në rolin e tyre për parandalimin e kriminalitetit dhe trajtimin e tij.

## **5. Heshtja e KPK-së dhe KGJK-së**

Në shtetet demokratike, ku sundon ligji, në mënyrë të pavarur dhe paanshme, ku integriteti i sistemit të drejtësisë mbrohet skajshëm, në rrethanat e rastit “Kobra”, KGJK dhe KPK, do të duhej të alarmoheshin nga dështimi i sistemit të drejtësisë, në parandalimin e një revidivisti nga kryerja e veprave penale. Fatkeqësisht, deri më tani, të dy këto institucione nuk janë deklaruar për këtë rast.

Heshtja e KGJK dhe KPK dhe mekanizmave të tjerë të kontrollit përballë një rasti në të cilin është i përfshirë një i dënuar për 16 herë radhazi, ku asnjëri prej dënimeve të shqiptuara nuk është me burgim efektiv, të paktën në minimumin e tij, ia humb kuptimin edhe mekanizmave të brendshëm të kontrollit. Përballë këtij dëmi të shkaktuar, reagimi i këtyre këshillave përmes mbajtjes llogaridhënës të të gjithë akterëve të përfshirë në këtë rast dhe informimit të publikut është i domosdoshëm.

Është interes publik të dihet se:

- 1) Sa herë është informuar gjykata nga prokuroria se i njëjti është recidivist?
- 2) Sa herë gjykata sipas detyrës zyrtare ka kërkuar të informohet se a është kryesi i veprës penale me të kaluar kriminale?
- 3) Ndaj 16 aktgjykimeve, në sa prej tyre është bërë ankesa nga ana e prokurorisë lidhur me dënimin e caktuar?
- 4) Pse gjykatat kanë zbatuar këtë politikë ndëshkimore, që ka rezultuar me mos arritje të vazhdueshme të qëllimit të dënimit?
- 5) Pse prokuroria nuk ndërmerret masa për të parandaluar krimet, ndaj një personi që në mënyrë publike promovon jetën e tij kriminale, të kaluarën e tij kriminale dhe armëmbajtjet pa leje?
- 6) A ka filluar nga KPK dhe KGJK verifikimi dhe analizimi i trajtimit të rasteve nga ana e prokurorisë dhe gjykatës në rastin e z.Hoxha?

- 7) Ministria e Drejtësisë, respektivisht Shërbimi Sprovues i Kosovës, a ka mbikëqyrur ekzekutimin e dënimeve me kusht të shqiptuara ndaj z.Hoxha?
- 8) Gjykata që ka shqiptuar dënimin, a është informuar me raporte nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, i cili është kompetent në organizimin, zbatimin e mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të ri integritit shoqëror të personave të dënuar?
- 9) Ndonjëra nga veprat penale a është kryer gjatë periudhës verifikuese të dënimit me kusht? Nëse po, cilat janë masat që janë ndërmarrë ndaj të njëjtit?
- 10) Policia e Kosovës, respektivisht ajo Drejtoria Rajonale e Prizrenit, cilat veprime i ka ndërmarrë lidhur me gjithë veprat penale për të cilat Hoxha ka raste të hapura në Polici?
- 11) Çfarë hapash ka ndërmarrë Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren ndaj një personi me të kaluar të bujshme kriminale, i cili dënohet vazhdimisht?
- 12) Sa raste të hapura në Policinë e Kosovës, i ka trajtuar Prokuroria, si kanë përfunduar këto raste?
- 13) Cilat janë veprimet konkrete hetimore që prokuroria i ka ndërmarrë me trajtimin e rasteve të këtij personi?

Mos reagimi institucional në këto raste, zbeh besimin e publikut në institucionet të cilat administrojnë me sistemin e drejtësisë. Situata të tilla, do të duhej të ishin alarmante, në drejtim të mbajtjes përgjegjës të gjithë personave zyrtarë, të cilët me mosveprimin apo veprimin e tyre, nuk i përmbushin obligimet dhe përgjegjësitë e tyre që burojnë nga ligji dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe lejojnë klimën ku persona me të kaluar voluminoze kriminale gjenden në liri dhe me lehtësi, me statistika, promovojnë krimet e kryera. Heshtja e këtyre institucioneve është qasja më negative që mund të ndjeket.